

Vendim: Nr. 01/08/16.009

Data: 01.08.2016

Në bazë të Pikës 5. të Politikës së transferit dhe njohjes së kredive në CE të datës 01.08.2016, Cactus Education aprovon këtë:

POLITIKA E TARIFAVE PËR VLERËSIMIN DHE NJOHJEN E KREDIVE PARAPRAKE

1. Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për transferin e kredive është **15.00 EUR** për çdo kredi ECVET/ECTS.
2. Tarifa paguhet paraprakisht nga studenti dhe është e pakthyeshme pavaresisht rezultatit të vlerësimit.
3. Kërkesa për transferin e kredive mund të bëhet nga studenti në çdo kohë, përmëtepër:
 - a. kërkesa në fillim të semestrit, e parashtruar brenda dy javëve të para pas fillimit të semestrit, në qoftë se rezulton me vendim pozitiv për pranimin e kredive, e liron studentin nga pagesa e rregullt për kursin për të cilin student ka aplikuar për transferim të kredive paraprake.
 - b. kërkesa e parashtruar pas kalimit të më shumë se dy javëve pas fillimit të semestrit, pa marrë parasysh rezultatin e vlerësimit të kërkesës, nuk e liron studentin nga pagesa e rregulltë për lëndën për të cilën studenti ka bërë kërkesë që t'i bëhet transferi i kredive paraprake.
4. Shuma e tarifës distribuohet si në vijim:
 - a. 10.00 EUR nga tarifa për çdo kredi i alokohen mësimdhënësit(ve) të lëndës për të cilën kërkohet njohja apo transferi i kredive paraprake për punën në shqyrtimin e dokumentacionit, dhe
 - b. 5.00 EUR nga tarifa për çdo kredi i alokohen institucionit për shpenzime administrative.

Tabela më poshtë ilustron tarifën e transferimit të lëndëve në varësi të numrit të kredive:

Kreditë	Tarifa e transferit të kredive	Alokuar për mësimdhënës(t)	Tarifa administrative
4	60.00	40.00	20.00
6	90.00	60.00	30.00
8	120.00	80.00	40.00

Kjo politikë hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në sjelljen e një vendimi për ndryshimin e saj.

Drejtori i shkollës

Kastriot Fazliu



Address // Rexhep Mala 27, Prishtina, Kosovo
Phone // +381 (0)38 22 63 61
Email // info@cactus.education
Web // www.cactus.education